



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 9 Regj.Them.
Dt. Regj. 07.04.2023

Nr. 9 Vendimi
Dt. Vendimi 13.04.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Marsela DERVISHI	<i>(Relatore)</i>
Gjyqtare:	Esmeralda XHILI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Emona MUÇI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Blerona HASA	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Alma KOLGJOKA	<i>(Anëtare)</i>

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 13.04.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.9 akti, datë 07.04.2023 që i përket:

PADITËS: **1-Partia “Nisma Thurje”,** përfaqësuar nga Kryetari Z.Endrit Shabani.

2-Kosta Garo, i biri i Thomait dhe i Margaritës, i datëlindjes 21.05.1976, lindur në Vrisera, në cilësinë e kandidatit për kryetar të Bashkisë Dropull.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,** përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 3721 Prot., datë 12.04.2023, nga Z.Ina Osmanaj.

OBJEKTI: - Ndryshimin e Vendimit nr. 10 datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 82, dhe Vendimit nr. 43 datë 03.04.2023 të Komisionit të Apelimeve dhe Sanksioneve.

-Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendosë regjistrimin e subjektit Partia “Nisma Thurje” dhe kandidatit Kosta Garo si kandidat për kryetar i Bashkisë Dropull në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 68, 73, 124, 126, 145 të Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 i ndryshuar, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”; Nenet 130, 131 të

Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; Neni 12 i Udhëzimit nr. 1, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

Në seancën e datës 13.04.2023, pasi dëgjoji pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

1. Se pala paditëse, Partia “Nisma Thurje” dhe Kosta Garo i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Ndryshimi i vendimit nr. 10 datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 82, dhe vendimit nr. 43 datë 03.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*”. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 18.01.2023 për “Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pala paditëse partia “Nisma Thurje” ka depozituar në datë 27.03.2023, në KZAZ nr. 82 të Bashkisë Dropull, Qarku Gjirokastër, dokumentacionin e paditësit z. Kosta Garo për t’u regjistruar si kandidat për Kryetar bashkie i subjektit zgjedhor “Nisma Thurje”.

3. Referuar “Librit të Protokollit të Mbledhjes” të KZAZ nr. 82 të bashkisë Dropull, qarku Gjirokastër datë 27.03.2023, ora 00:20 për palën paditëse Partia “Nisma Thurje” u konstatua se:

“... pasi u konstatuan mungesa në dokumentacionin dhe në mungesë të sekretarit me vulën përkatëse iu komunikua kandidatit, z. Kosta Garo të plotësojë sipas dispozitave të kodit zgjedhor kartat e identitetit ID (Fotokopje) me nënshkrimet e zgjedhësve brenda orës 18:00 për të plotësuar dokumentacionin datë 28.03.2023”.

4. Në vijim në datë 28.03.2023 ora 20:00 është mbajtur mbledhja e KZAZ nr. 82 e Bashkisë Dropull të qarkut Gjirokastër, mbi verifikimin e dokumentacionit të subjektit “Nisma Thurje” për regjistrimin e z. Kosta Garo kandidat për kryetar bashkie, ku sipas shënimeve të bëra në librin e protokollit, është konstatuar se:

1. Panajot Xarxallo, me tel 00306988551449 ky numër nuk ekziston;
2. Dhimiter Vrano, me tel 00306942487282 del një person tjetër (me emër tjetër);
3. Pandeli Shuti, me numër 0693392256 u përgjigj një grua që nuk e njihë personin;
4. Garufo Shuti, me tel 0693392256 del një emër tjetër gruaje (invalite në Gjirokastër);
5. Në listë numri 50 dhe 22 janë i njëjti person 2 herë i regjistruar;
6. Laureta Cami, me tel 00306947879691 me numër të dhëna të pasakta;
7. Jorgo Vllaho, me numër tel 0692056616 të dhëna të pasakta;
8. Ioani Baruta, të dhëna të pasakta;
9. Luljeta Kashuta nënshkrim i gabuar;
10. Nr. rendor 153, 154, 155 (nënshkrim i gabuar);
11. Dhimitri Lufi (nënshkrim i gabuar del në tel tjetër person);
12. Nr. rendor 145,146 të dhëna të gabuara;
13. Nr. rendor 202 të dhëna të gabuara;
14. Nr. rendor 207 (Ollga Mastora) të dhëna të gabuara;
15. Mihal Dhima, të dhëna të gabuara;
16. Krisanthi Ngjelo nuk ekziston numri i telefonit;
17. Harallamb Qiro nuk ekziston numri i telefonit;

Në bazë të protokollit të datës 27.03.2023 subjektit i është lënë afat data 28.03.2023 për paraqitjen e listave ora 18:00.

Stafi i KZAZ priti deri në orën 20:55 dhe përsëri subjekti nuk paraqiti dokumentat ID dhe nënshkrimet. Për këtë arsye, KZAZ mori vendim të mospranimi të kandidaturës së subjektit “Nisma Thurje”.

5. Në këto kushte, KZAZ nr. 82 e Bashkisë Dropull, Qarku Gjirokastër, me vendimin nr. 10, datë 28.03.2023, ka vendosur mosregjistrimin si kandidat të z. Kosta Garo, për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt.

6. Pala paditëse partia “Nisma Thurje”, duke mos qenë dakord me vendimin nr. 10, datë 28.03.2023 të Bashkisë Dropull i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesë ankimore, ku pretendon se: “Dokumentet e dorëzuara nga ana e subjektit z. Kosta Garo janë të plota, të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe në përputhje me kërkesat ligjore; nëse KZAZ do të kishte konstatuar mungesë dokumentacioni, do të duhej ta kishte pasqyruar këtë fakt në procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, gjë që nuk ka ndodhur; mosregjistrimi i kandidatit Kosta Garo është i pajustificuar nga KZAZ nr. 82, anëtarët e së cilit nuk kanë dhënë asnjë argument për vendimmarrjen e tyre; kërkojnë regjistrimin e kandidatit Kosta Garo, si kandidat i subjektit “Nisma Thurje”, për kryetar bashkie në bashkinë Dropull”.

7. Në seancën e datës 03.04.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mori në shqyrtim kërkesën ankimore të palës paditëse partia “Nisma Thurje” dhe në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 143, pika 1, shkronjën “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr. 43, datë 03.04.2023 vendosi:

“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 39, datë 29.03.2023 të paraqitur nga Partia “Nisma Thurje”.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 82, Bashkia Dropull.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”.

8. Referuar vendimit të marrë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezulton se:

1. Subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe anëtarët e KZAZ-së nr. 82 të Bashkisë Dropull paraqitën përpara KAS-it dy rrëfime të kundërta lidhur me zbatimin e procedurës për regjistrim të kandidatit të këtij subjekti për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo. Subjekti deklaroi se dorëzimi i dokumentacionit të kandidimit ishte bërë dhe ishte pranuar më datë 27.03.2023 pa asnjë mangësi, kurse KZAZ-ja nr. 82 pretendoi se kishte konstatuar mangësi të fotokopjeve të letërnjoftimeve në listat me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve dhe, për këtë arsye, i kishte lënë kandidatit afat për dorëzimin e dokumentacionit që mungonte, deri më datë 28.03.2023, ora 18:00.

2. Subjekti dhe kandidati e mbështesnin deklarinimin e tyre tek prova shkresore “Procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit” (procesverbali model KQZ-00-31), që mban datën 27.03.2023 dhe është nënshkruar nga Kosta Garo, në cilësinë e dorëzuesit të dokumenteve dhe nga Gligor Dushi, në cilësinë e marrësit në dorëzim për KZAZ. Procesverbali është i hartuar në formën e një formulari dhe ka në krah të shënuar me shenjën (X) këto dokumente:

1. Formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ-04-01; 2. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie propozuar nga parti politike/koalicion Model KQZ-04-06; 3. Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme Model KQZ-04-08; 4. Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09; 5. Jetëshkrimi i kandidatit Model KQZ-04-10; 6. Formular i vetëdeklarimit; 7. Dokumentin identifikues për kandidatin për kryetar bashkie/anëtar në këshillin bashkiak.

3. KZAZ-ja e mbështet pretendimin e saj tek shënimet në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 82, përkatësisht shënimi i datës 27.03.2023, ora 00:20, në të cilin shkruhet se “pasi u konstatuan mungesa në dokumentacionin dhe në mungesë të sekretarit me vulën përkatëse iu komunikua kandidatit, z. Kosta Garo të plotësojë sipas dispozitave të kodit zgjedhor kartat e identitetit ID (Fotokopje) me nënshkrimet e zgjedhësve brenda orës 18:00 për të plotësuar dokumentacionin datë 28.03.2023”, si dhe shënimi i datës 28.03.2023, ora 20:00, në të cilin, ndër të tjera, shkruhet se “Stafi i KZAZ priti deri në orën 20:55 dhe përsëri subjekti nuk paraqiti dokumentat ID dhe nënshkrimet. Për këtë arsye KZAZ mori vendim të mospranimit të kandidaturës së subjektit “Nisma Thurje” për kandidat për kryetar të bashkisë në zgjedhjet vendore 14 maj 2023 për arsye të mungesës së dokumentacionit”. Procesverbali është nënshkruar në çdo faqe nga të gjithë anëtarët në detyrë të KZAZ-së (katër anëtarë), por nuk është vulosur për shkak të mungesës së sekretarit të KZAZ-së.

4. Procesverbali model KQZ-00-31 është dokument zyrtar që pasqyron dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit, por nuk përmban asnjë të dhënë lidhur me shqyrtimin tij. Për marrjen në dorëzim të dokumenteve KZAZ-ja cakton një përfaqësues, kurse shqyrtimin e tyre e bën si trupë, në harkun e tri ditëve nga momenti i dorëzimit. Marrja në dorëzim finalizohet me procesverbalin model KQZ-00-31, kurse shqyrtimi finalizohet me vendimin model KQZ-01-19. Në rastin e ankuesit, shqyrtimi është finalizuar me vendimin nr. 10, datë 28.03.2023, ora 21:23.

5. Kompetencën për kthimin për plotësim të dokumentacionit nuk e ka përfaqësuesi i KZAZ-së që merr në dorëzim dokumentacionin, por e ka KZAZ-ja si trupë. Kthimi për plotësim nuk formalizohet me një akt të caktuar, por formalizohet me një shënim në librin e protokollit të

mbledhjeve të KZAZ-së. Në çështjen objekt shqyrtimi, ky shënim është bërë në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, pas mesnatës së datës 27.03.2023.

6. Procesverbali model KQZ-00-31 konfirmon dorëzimin e formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati, por nuk jep asnjë të dhënë për mënyrën e plotësimit të tij, për përmbajtjen apo për dokumentacionin shoqërues. Të gjitha këto të dhëna shyrtohen vetëm në procedurë shqyrtimi. Gjatë shqyrtimit verifikohet numri i zgjedhësve me nënshkrimet mbështetëse, verifikohen të dhënat e tyre personale, përfshirë të dhënat e letërnjoftimit, përkatësia e tyre në listën e zgjedhësve, në tërësi rregullsia dhe plotësia e formularit. Prandaj pretendimi se dorëzimi/pranimi i dokumentacionit rrëzon shkresërisht pretendimin se dokumentacioni ka qenë i paplotë dhe i parregullt është i papranueshëm në pikpamje procedurale.

7. Procesverbali model KQZ-00-31 nuk ka asnjë rubrikë ku të shënohet se është bërë dorëzimi i fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve që mbështetin kandidimin. Kjo do të thotë për ankuesin, se procesverbali model KQZ-00-31 nuk mund të përdoret prej tij si provë pozitive se ai ka bërë faktikisht dorëzimin fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve, sepse procesverbali nuk e përmban këtë informacion.

8. Ankuesi kundërshtoi në seancë besueshmërinë e shënimeve në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 82, për shkak se KZAZ-ja funksionon përkohësisht si trupë politikisht e njëanshme dhe i mungon sekretari që të mbajë përgjegjësi dhe të certifikojë shënimet në librin e protokollit të mbledhjeve. Kjo përbën një situatë faktike që është e pavarur nga vullneti i KZAZ-së, për të cilën anëtarët në detyrë nuk mbajnë përgjegjësi as për krijimin, as për ekzistencën e saj. Kjo situatë gjithashtu nuk ka lidhje as me ankuesin dhe as ka ardhur për shkak të procedurës së regjistrimit të kandidatit të tij.

9. Besueshmëria publike në veprimtarinë e administratës zgjedhore mbështetet sipas Kodit Zgjedhor në dy shtylla. E para është balanca politike në kompozimin e trupës, kurse e dyta është e drejta për akses e subjekteve zgjedhore dhe transparenca e veprimtarisë. E drejta për akses përfshin jo vetëm të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të administratës zgjedhore, apo për të vëzhguar zbatimin e procedurave ligjore nga ana e tyre. E drejta për akses shtrihet edhe mbi dokumentacionin që administrata zgjedhore prodhon. Ajo përfshin edhe të drejtën për të bërë kontestime dhe për të kërkuar që kontestimet të shënohen në dokumentacionin e organit të administratës zgjedhore.

10. E drejta për akses nuk është kusht për ushtrimin e veprimtarisë së organeve të administratës zgjedhore. Ajo është garanci që jepet nga ligji, por vihet në zbatim nga vetë subjekti i interesuar. Nëse subjekti i interesuar i rri larg procedurave, nuk merr pjesë në mbledhje dhe nuk është proaktiv kur trupa shqyrton kërkesat e tij, atëherë pretendimet e tij për shkelje gjatë zbatimit të procedurave mund të merren veçse me rezervë.

11. Mungesa e lidhjes shkakësore midis procesit të regjistrimit të kandidatëve dhe përbërjes aktuale të pabalancuar të KZAZ-së nr. 82, si dhe mungesa e kandidatit ose e përfaqësuesve të autorizuar të subjektit përgjatë procedurës së shqyrtimit të dokumenteve të kandidimit e bëjnë të pamundur mbajtjen në këmbë të pretendimit për veprimtari “konspirative” të KZAZ-së nr. 82.

12. Gjithsesi, KAS-i thelloi hetimin edhe në këtë drejtim, duke thirrur të dëshmojë z. Arjan Gjini, i cili është monitorues i KQZ-së për zonën, njëkohësisht trainer i KQZ-së për administratën zgjedhore. Sipas dëshmisë së dhënë para KAS-it, z.Gjini ka monitoruar veprimtarinë e KZAZ-së nr. 82 përgjatë procedurave të regjistrimit të datës 28.03.2023 dhe ka mundur të konstatojë personalisht mungesën e dokumentacionit shoqërues të formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (mungesën e letërnjoftimeve). Z. Gjini ishte informuar nga anëtarët e KZAZ-së, se ishin në pritje të subjektit zgjedhor “Nisma

Thurje” për plotësimin e dokumentacionit, si dhe kishte asistuar teksa KZAZ-ja bënte veprimet e përshkruara në librin e protokollit për verifikimin e listës së zgjedhësve mbështetës të kandidatit.

13. Dëshmia e z. Gjini konfirmon në mënyrë të besueshme shënimet e KZAZ-së në librin e protokollit. Vetë z. Gjini rezulton dëshmitar i besueshëm, sepse ai më datë 28.03.2023 ka bërë raportim në KQZ për gjetjet nga monitorimi në këtë KZAZ, duke komentuar për ankuesin se “u konstatua se dokumentat e kandidatit të “Nisma Thurje” kishin mangësi në përmbajtje”, konstatim që është depozituar në KQZ rreth orës 15:00 të datës 28.03.2023, kohë përpara se KZAZ-ja të merrte vendimin për mospranimin e dokumentave të kandidimit.

14. KZAZ-ja nr. 82 i ka akorduar ankuesit 24 orë afat për plotësimin e dokumentacionit, sikurse provohet nga libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. Kodi Zgjedhor ka parashikuar një afat maksimal për kryerjen e plotësimeve dhe korrigjimeve në dokumentat e kandidimit, i cili nuk mund të shkojë përtej 45 ditëve përpara datës së zgjedhjeve, d.m.th. jo më vonë se data 30 mars 2023. Udhëzimi Komisionerit nr.1, datë 18.01.2023 nuk ka të përcaktuar si akordohet ky afat rast pas rasti. Çështja mbetet diskrecion i KZAZ-së, por nuk mund të jetë ushtrim arbitrariteti. Koha në dispozicion të subjektit për korrigjime dhe plotësime duhet të jetë racionalisht e mjaftueshme për kryerjen e tyre. Kjo do të thotë, se afati caktohet në bashkëpunim me palën e interesuar dhe me qëllimin e mirë që detyra e lënë të plotësohet saktësisht dhe me sukses. Afati i lënë prej 24 orësh në rastin konkret nuk mund të konsiderohet arbitrar nga ana e KAS-it, sepse me të nuk u lidh asnjë pretendim konkret në seancë.

15. KZAZ-ja nr. 82 ka verifikuar saktësinë e listës së zgjedhësve mbështetës të kandidatit dhe ka konstatuar parregullsi në të dhënat e 17 zgjedhësve. Ky konstatim gjithashtu është fiksuar në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, me shënimet përkatëse për secilin prej tyre. Verifikimi i të dhënave është bërë nëpërmjet thirrjeve telefonike. Nga këto shënime del se një pjesë e zgjedhësve kanë numra telefoni të pasaktë, për një pjesë tjetër nuk korrespondon identiteti i zgjedhësit me identitetin e mbajtësit të telefonit, për një pjesë të dhënat janë të gabuara, sikurse ka midis tyre që nuk janë banorë të bashkisë Dropull. Kryetari i KZAZ-së ngriti pretendimin se verifikimi provonte se personat e verifikuar nuk ishin zgjedhës të zonës dhe, për pasojë lista duhet të refuzohet për shkak numri i mbështetësve bie nën numrin minimal ligjor.

16. KZAZ-ja kryen procedurë verifikimi rastësor për emrat në listë, me qëllim që vertetojë nëse zgjedhësit i përkasin bashkisë, apo jo. Rregullat e KQZ-së (udhëzimi i Komisionerit nr.1, datë 18.01.2023) nuk kanë përcaktuar procedurën konkrete të verifikimit, duke i lënë dorë të lirë KZAZ-ve që të bëjnë verifikimin si ta gjykojnë ato më të përshtatshme. KZAZ-ja nr. 82 nuk disponon ende mbi listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore, si dhe nuk mund të bëjë verifikimin, duke konsultuar listën e zgjedhësve nga adresa ëëë.kqz.gov.al, sepse nuk ka pasur të përfshirë atësinë tek identitetit i zgjedhësve mbështetës. Rruga më e saktë për të do ishte të bënte verifikimin nëpërmjet zyrës së gjendjes civile të bashkisë Dropull.

17. Metoda që ka zgjedhur KZAZ-ja nr. 82 është e padobishme për qëllimet e verifikimit, sepse asnjë nga të dhënat që ajo ka përfutur nga thirrjet telefonike nuk provon nëse zgjedhësit bëjnë pjesë në listën e zgjedhësve të zonës, apo jo. Anëtarët e KZAZ-së shpjeguan se, për shkak të natyrës së zonës zgjedhore me numër të vogël zgjedhësish, ata i njihnin personalisht nënshkruesit dhe kishin bindjen se një numër i tyre nuk ishin banorë të zonës, ose jetonin familjarisht jashtë vendit dhe për këtë shkak kishte dyshime nëse ata ishin firmëtarët e listës së dorëzuar në datën 27.03.2023 si dhe fotove/fotokopjeve të kartave ID dhe pasaportave në një datë të mëvonshme.

18. KAS-i nuk mund t'i verifikonte në mënyrë të thelluar këto pretendime në procedurën e shqyrtimit administrativ. Prandaj KAS-i çmon se të dhënat e përfutura nga verifikimi i kryer nga

KZAZ-ja nuk mund të çojnë në refuzimin e kandidimit për shkak mangësive të listës me emrat e zgjedhësve mbështetës të kandidatit z. Kosta Garo.

19. Vendimi nr. 10 i KZAZ-së nr. 82, datë 28.03.2023 ka refuzuar regjistrimin për mungesë të dokumentacionit shoqërues të listës me emrat e zgjedhësve mbështetës dhe për mosplotësim të tij në afatin e caktuar nga KZAZ-ja nr. 82. Shkronja “g”, e nenit 3, të udhëzimit të Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 kërkon në mënyrë taksative që “formularit tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin, në përputhje me nenet 68, 70 dhe 71, të Kodit Zgjedhor sipas Modelit KQZ-04-01” t’i bashkëlidhet “fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga çdo zgjedhës”. Kjo kërkesë provohet se nuk është plotësuar nga subjekti dhe/ose kandidati edhe pas afatit të vendosur nga KZAZ-ja. Ky fakt i provuar e bën vendimin nr. 10 të KZAZ-së nr. 82 të ligjshëm.

20. Në procedurën e shqyrtimit të ankimit administrativ, KAS-i ka detyrë të shqyrtojë ligjshmërinë e veprimeve të KZAZ-së, jo të marrë dhe ushrojë kompetencat në emër të saj. KAS-i ka kompetencë të vendosë prishjen e vendimeve të paligjshme të KZAZ-ve, jo të vendimeve që janë marrë në përputhje me ligjin dhe me kompetencën institucionale të tyre”.

9. Ky vendim i KAS kundërshtohet në këtë gjykim nga pala paditëse Partia “Nisma Thurje” nëpërmjet Kryetarit të tij z.Endrit Shabani dhe nga kandidati për Bashkinë Dropull z. Kosta Garo, të cilët në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, kanë pretenduar se:

- Në datë 27 Mars 2023 Partia Nisma Thurje, paraqiti përpara KZAZ-se Nr.82 në Dropull, kërkesën për të regjistruar kandidatin Kosta Garo për kryetar të bashkisë Dropull në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kjo kërkesë u shoqërua nga dokumentacioni mbështetës, sipas parashikimeve të Nenit 72 te Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
- Në mesnatën e datës 27 Mars 2023 (ora 00:23 minuta), KZAZ-ja Nr.82, në një mbledhje pa praninë e kandidatit Kosta Garo, pretendon se ka konstatuar parregullsi në dokumentacionin e dorëzuar prej tij dhe i ka vendosur një afat për plotësimin e dokumentacionit deri në orën 18:00 të datës 28 Mars 2023 (rreth 17 orë pas mbledhjes). Në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se Nr.82, nuk është shënuar as ora kur pretendohet se kur është njoftuar kandidati Kosta Garo, dhe as mënyra se si ka ndodhur ky njoftim.
- Kandidati Kosta Garo pretendon se ka mësuar për pretendimet mbi mungesën e dokumentacionit vetëm mbrëmjen e datës 28 Mars 2023, kur KZAZ-ja Nr.82 i ka kërkuar të tërheqë mbrapsht dokumentacionin që ai kishte depozituar me datë 27 mars 2023, pasi ishte vendosur mosregjistrimi i tij në zgjedhje. Ky afat i pretenduar nga KZAZ-ja Nr.82, është gjithsesi shumë më i shkurtër se afati maksimal i vendosur nga Kodi Zgjedhor apo nga udhëzimi nr. 1 datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Me vendimin nr.10 datë 28 Mars 2023 KZAZ-ja Nr.82, në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kushtetutës, vendosi mosregjistrimin e Kandidatit Kosta Garo dhe subjektit Nisma Thurje në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Vendimi Nr.10 te KZAZ Nr.82, nuk ka shpjeguar arsyet e mosregjistrimit të kandidatit Kosta Garo, duke vështirësuar përgatitjen e ankimit të subjektit Nisma Thurje dhe përgatitjen e mbrojtjes përpara Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.
- Me datë 29 Mars 2023 subjekti Nisma Thurje dhe kandidati Kosta Garo iu drejtuan KQZ-së një ankim administrativ kundër vendimit nr. 10 të KZAZ-se nr. 82. Pjesë e dokumenteve shoqëruese të ankimit në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)

të KQZ-së ishte edhe një kopje e të gjithë dokumenteve të kandidimit, përfshi një fotokopje të kartave të identitetit. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), me vendimin nr. 43, datë 03.04.2023 la në fuqi vendimin nr.10 të KZAZ-se nr. 82, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, Kushtetutës së RSH dhe Rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

- Në 28 Mars 2023, në orën 21:23 katër anëtarët e Partisë Socialiste në KZAZ-në Nr.82 kanë vendosur me vendimin Nr.10 mosregjistrimin e subjektit Nisma Thurje dhe kandidatit Kosta Garo në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023. Ky vendim është bazuar në dy pretendimet e mëposhtme:
- Dokumentacioni i kandidimit i dorëzuar nga kandidati Kosta Garo nuk ka qenë i plotë dhe nuk është plotësuar brenda afatit të vendosur nga KZAZ-ja dhe disa prej zgjedhësve që kanë nënshkruar në mbështetje të kandidatit, nuk janë zgjedhës në bashkinë Dropull, duke bërë që numri total i nënshkrimeve të jetë më i vogël se kërkesa ligjore.
- Pala paditëse kundërshton pretendimin për mungesën e dokumentacionit në momentin e dorëzimit të dokumenteve të kandidimit si të pabazuar në ligj dhe në prova, edhe pse me datë 27 Mars 2023, KZAZ-ja nr. 82 ka pranuar kërkesën e subjektit Partia Nisma Thurje për t'u regjistruar në zgjedhje, si dhe dokumentet mbështetëse të dorëzuara nga kandidati Kosta Garo, një ditë më vonë, me datë 28 Mars 2023, kryetari i KZAZ-së, z. Gligor Dushi ka ngritur pretendimin se në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, kandidati Kosta Garo nuk ka paraqitur fotokopje të kartave të identitetit të 215 mbështetësve, të cilët kanë nënshkruar në formularin Model KQZ-04-01 në mbështetje të kandidimit.
- Dispozitat e Kodit Zgjedhor, neni 73 e ngarkon KZAZ-në që të verifikojë dokumentacionin e dorëzuar për kandidim. Në formë, ky verifikim nis në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, ku përfaqësuesi i KZAZ-së kontrollon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet politike. Për të vërtetuar dokumentacionin e dorëzuar në KZAZ, KQZ-ja ka miratuar një procesverbal tip Model KQZ-00-31, i cili nënshkruhet nga dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim i dokumentacionit. Procesverbali i dorëzimit të dokumenteve të kandidimit (model KQZ-00-31) është firmosur me datë 27 Mars 2023 nga Kosta Garo, në cilësinë e dorëzuesit të dokumenteve, dhe nga Gligor Dushi, në cilësinë e marrësit në dorëzim për KZAZ-në Nr.82, me detyrë kryetar i KZAZ- së Nr.82 të njësisë administrative Dropull. Ky procesverbal vërteton se janë dorëzuar dokumentet e mëposhtme:
 1. Formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ-04-01;
 2. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie propozuar nga parti politike/koalicion Model KQZ-04-06;
 3. Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme Model KQZ-04-08;
 4. Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09;
 5. Jetëshkrimi i kandidatit Model KQZ-04-10;
 6. formular i vetëdeklarimit;
 7. Dokumentin identifikues për kandidatin për kryetar bashkie/anëtar në këshillin bashkiak.
- Në nenin 71, pika 2 e Kodit Zgjedhor, lista dhe fotokopjet e kartave të identitetit, konsiderohen si një dokument i vetëm. Gjithashtu edhe formulari tip KQZ-00-31 të përgatitur nga KQZ nuk ka asnjë seksion të veçantë për fotokopjen e kartave të identitetit të nënshkrimeve mbështetëse, duke konfirmuar që KQZ-ja i trajton këto dy dokumente si pjesë integrale të njëra-tjetrës. Pra dokumenti quhet i plotësuar kur dorëzohet sëbashku me një fotokopje të kartave të identitetit për secilin prej nënshkruesve. Për ligjëvënësin fotokopja e kartave të identitetit është trajtuar si pjesë përbërëse e pikës 1 në formularin Model KQZ-00- 31, që është formulari për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për

mbështetje kandidati. Gjithashtu, ky formular ka një seksion të veçantë për vërejtje, ku shënohet mungesa e dokumentacionit, ç'ka duhet të verifikohet në momentin e dorëzimit të dokumenteve. Qëllimi i këtij seksioni është pikërisht për të evidentuar çdo mungesë apo parregullsi në dokumentacionin e dorëzuar, që mund të vërehet në momentin e dorëzimit. Duhet theksuar se mungesa e fotokopjes së kartave të identitetit është lehtësisht e verifikueshme në fazën e parë të pranimit të dokumentacionit, pasi fizikisht ato përbëjnë 215 faqe letër A4. Gjithashtu, ato janë një dokument tepër thelbësor për të mos u vënë re nga marrësi në dorëzim i dokumentacionit, gjë që do të kishte sjellë shënimin në seksionit e vërejtjeve. Prandaj pala paditëse beson se mungesa e të gjithë fotokopjeve të kartave të identitetit do përbënte rastin tipik të vërejtjeve të paraqitura në këtë formular, gjë e cila nuk ka ndodhur.

- Në procesverbalin e nënshkruar prej kryetarit të KZAZ-së Nr.82 në datë 27 Mars 2023, është shënuar se dokumentacioni i dorëzuar është i plotë, dhe nuk është shënuar asnjë vërejtje për mungesë dokumentacioni. Gjithashtu neni 254 i Kodit Zgjedhor parashikon se "aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore [...]që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre". Duke besuar se procesverbali i dorëzimit të dokumenteve të kandidimit përbën provë të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi, i gjejnë të pabazuara në ligj dhe në prova pretendimet e ngritura nga KZAZ Nr.82 për mosdorëzim të dokumentacionit të plotë të kandidimit.
- Mbledhjet e datës 28 Mars 2023 të KZAZ-së Nr.82, ku është verifikuar dokumentacioni i paraqitur nga kandidati Kosta Garo dhe ku është vendosur mosregjistrimi i tij, janë zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor të RSH. Neni 71, pika 3 e Kodit Zgjedhor, e detyron KZAZ-në në mënyrë eksplicite që të zhvillojë një "seancë publike, ne prani të palës së interesuara" ku paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Me tej, pika 4 e nenit 71, kërkon që edhe "procedura e verifikimit të zhvillohet në mënyrë publike". Nga provat e bashkangjitura kësaj padie, seanca e verifikimit të dokumentacionit të subjektit Nisma Thurje nuk është zhvilluar në mënyrë publike dhe ajo është zhvilluar pa praninë e kandidatit Kosta Garo.
- Gjithashtu, KZAZ-ja Nr. 82 pretendon se kandidati Kosta Garo është njoftuar për mungesën e dokumentacionit dhe i është dhënë afat për ta plotësuar atë brenda orës 18:00 të datës 28 Mars 2023. Ky pretendim nuk mbështetet në asnjë provë dhe se Z. Garo mohon të ketë qenë në dijeni të këtyre pretendimeve, i takon KZAZ- se Nr.82 që të ofrojë prova që vërtetojnë ekzistencën e komunikimit te pretenduar apo njoftimit të subjektit për mungesën e dokumentacionit dhe afatin e vendosur. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor, ka sjellë mungesën e transparencës në këtë proces, duke penguar kandidatin Kosta Garo dhe subjektin Nisma Thurje që të mbrojnë interesat e saj të ligjshme.
- Është e rëndësishme të theksohet se edhe afati i pretenduar prej 24 orësh, i cili është vendosur në mbledhjen të datës 28 Mars 2023, ora 00:23 e mesnatës, është arbitrar dhe në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, i cili në nenin 73, pika 2, parashikon se në rastet kur KZAZ-ja vëren parregullsi ia kthen dokumentacionin subjektit zgjedhor për korrigjim, dhe "dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve". Gjithashtu udhëzimi nr. 1 datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, neni 12, caktohet një afat maksimal prej 9 ditësh nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit, dhe 7 ditë nga përfundimi i afatit prej 48 orësh për shqyrtimin e

dokumentacionit të dorëzuar, duke qenë se data e zgjedhjeve është 14 Maj 2023, ky afat mbaron me datë 4 Prill 2023.

- KZAZ-ja nr. 82, në mënyrë krejt të kundraligjshme, e ka limituar afatin maksimal për plotësimin e dokumentacionit në orën 18:00 të datës 28 Mars 2023, pra vetëm 17 orë mbas mbajtjes së mbledhjes për shqyrtimin e dokumentacionit, dhe 49 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, edhe sikur pretendimet e KZAZ-së të ishin të bazuara në fakte, ajo nuk legjitimohet të kufizojë një të drejtë që është e garantuar nga Kodi Zgjedhor, apo të veprojë në kundërshtim me udhëzimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për më tepër me datë 29 Mars 2023, 48 ditë përpara datës së zgjedhjeve, subjekti Nisma Thurje dhe kandidati Kosta Garo, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një kopje të plotë të të gjithë dokumentacionit, ku përfshihen edhe nënshkrimet e 215 zgjedhësve të bashkisë Dropull, sëbashku me një kopje të kartave të tyre të identitetit. Në këto kushte, të dhënat protokollare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konfirmojnë se subjekti Nisma Thurje i ka marrë të gjitha masat e duhur për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Dropull në zgjedhjet e 14 Majit 2023.
- Pala paditëse thekson se gjatë seancës së shqyrtimit të ankesës Nr. 39 në KAS, përfaqësuesit e Nismës Thurje ngritën pretendime për këtë afat, duke e konsideruar atë arbitrar dhe në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor. Këto pretendime janë ngritur edhe në kërkesën ankimore Nr.39 të datës 29 Mars 2023 të depozituar në KQZ.
- Pala paditëse kundërshton pretendimin e dytë të KZAZ-së Nr.82, se disa prej zgjedhësve që kanë nënshkruar për të mbështetur kandidimin e kandidatit Kosta Garo nuk janë zgjedhës në bashkinë Dropull, si të pabazuar në prova.

Në seancën e datës 03 Prill 2023, përpara Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) Drejtuesit e KZAZ-së Nr.82 ngritën pretendimin se një pjesë e listës së personave që kanë nënshkruar në mbështetje të kandidatit Kosta Garo nuk janë zgjedhës në bashkinë Dropull. Ata paraqitën edhe një kopje të procesverbalit të mbledhjes së datë 27 Mars 2023, ku nga pretendimi se pas verifikimeve të bëra, kishin konstatuar disa numra telefoni të apo persona që nuk banonin në Dropull.

Kodi Zgjedhor në mënyrë eksplicite e kufizon objektin e verifikimit të KZAZ-se vetëm nëse [nënshkruesit] janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Në këto kushte nëse neni 71, pika 3, kërkon që KZAZ-ja të zbresë nënshkrimet e personave që nuk figurojnë zgjedhës në njësinë vendore përkatëse nga numri total i nënshkrimeve të dorëzuara, dhe të pranojë listën e mbështetësve vetëm nëse ajo "është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi".

Subjekti Partia Nisma Thurje, nuk gëzon asnjë mandat deputeti apo anëtar të këshillit bashkiak Dropull. Kështu që, sipas nenit 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcaktohet se: Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës.

Sipas regjistrimit të gjendjes civile, Bashkia Dropull ka më pak se 20 mijë zgjedhës të regjistruar në listat zgjedhore. Kështu që numri i nënshkrimeve prej 1% e zgjedhësve, nuk duhet të jetë më pak se 200 mbështetës. Duke qenë se kandidati Kosta Garo ka paraqitur në KZAZ (në datë 27 Mars 2023) dhe në KQZ (në datë 29 Mars 2023) nënshkrimet dhe kartat e identitetit të 215 zgjedhësve të bashkisë Dropull, atëherë, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor do të quhej i papërmbushur ky kusht i Kodit Zgjedhor nëse KZAZ-ja Nr. 82 të identifikonte më shumë se 16 persona në formularët për

mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (Model KQZ 04-01) të cilët nuk kanë qenë zgjedhës të bashkisë Dropull në momentin e nënshkrimit.

Përpara KAS-it përfaqësuesit e KZAZ-së Nr.82 në Dropull paraqitën pretendime për vendbanimin e 16 prej personave që kanë nënshkruar në formularin Model 04-01 në mbështetje të kandidimit të Kosta Garos. Kjo listë me emra është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbledhjes së datës 28 Mars 2023. Gjatë seancës ankimore përpara KAS-it në datën 03 Prill 2023, drejtuesit e KZAZ-së nr.82 konfirmuar se ata nuk e kishin bërë asnjë përpjekje për të marrë në dispozicion listën e zgjedhësve të bashkisë Dropull, ç'ka tregon jo vetëm se ata kanë dështuar për të verifikuar vërtetësinë e pretendimeve të tyre, por edhe mungesën e vullnetit për të kryer detyrat e tyre siç i ngarkon ligji. Kjo sjellje vë në dyshim qëllimin e tyre për të refuzuar mosregjistrimin e kandidatit Kosta Garo në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Nga ana tjetër, duke synuar të vërtetojmë se nuk jemi përpara kushteve të parashikuara nga neni 71 i Kodit Zgjedhor, pala paditëse i ka kërkuar personave të përmendur në procesverbalin e mbledhjes që të verifikojnë adresën e tyre të qendrës së votimit duke përdorur portalin e KQZ-së dhe e-Albanian. Bashkangjitur kësaj padie do gjeni të printuar të dhënat e e-Albanias për të gjithë personat e mëposhtëm, ku vërtetohet fakti që ata figurojnë të regjistruar në listën e zgjedhësve të Bashkisë Dropull. Secili prej vërtetimeve të nxjerra nga e-Albania tregon edhe të dhëna të tjera mbi numrin zgjedhor të secilit, numrin rendor në listën e zgjedhësve si dhe të dhëna të tjera që përkojnë me të dhënat e kartës së tyre të identitetit (një kopje të së cilës është dorëzuar sëbashku me këtë padi), 1.Panajot Jorgji Xarxallo 2. Ioani Llambi Baruta, 3. Dhimiter Mihai Vrano, 4.Jani Mihai Dhima, 5. Dhimitri Jorgji Lufi, 6. Pandeli Spiro Shutu, 7. Jorgo Kristofor Vllaho, 8. Ollga Jani Mastora, 9. Sofia Andon Noti, 10. Vasillaq Sokrat Baxheli, 11. Garufo Jani Shutu, 12. Harallamb Thodhori Qiro, 13. Aleksandra Dhimitri Baxheli, 14. Jani Andrea Noti. Këto të dhëna janë publike, dhe kushdo mund të vizitojë faqen e KQZ-së ose e-Albania dhe të verifikojë në kohë reale që këta persona në fakt janë zgjedhës të bashkisë Dropull. Kjo tregon edhe një herë mungesën e vullnetit të KZAZ-së Nr.82 për të vërtetuar vërtetësinë e pretendimeve të tyre apo për të zbatuar ligjin.

- Në konkluzion, pala paditëse kërkon që të shikohet qartë duke vlerësuar edhe vullnetin dhe qëllimin e palëve të përfshira në këtë konflikt.

Nga njëra anë, KZAZ-ja Nr.82 ka shfaqur mungesë të hapur vullneti për të garantuar të drejtën kushtetuese të Kosta Garos për t'u zgjedhur. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, anëtarët e KZAZ-së Nr.82, kanë dëshmuar synimin për të penguar regjistrimin e kandidatit Kosta Garo në zgjedhje. Për këtë mjafton të shohësh jo vetëm pretendimet e pabazuara në fakte dhe në prova, por vetë afatin që pretendohet se i kanë lënë kandidatit Kosta Garo, i cili është shumë më i shkurtër se afati që cakton Kodi Zgjedhor për plotësimin e dokumentacionit. Tendenca për të kufizuar një afat që ia garanton vetë Kodi Zgjedhor, ekspozon mungesën e vullnetit të KZAZ-së Nr.82 për të regjistruar kandidatin Kosta Garo dhe subjektin Nisma Thurje në zgjedhje.

- Nga ana tjetër, kandidati Kosta Garo ka dëshmuar me veprimet e tij, vullnetin për të përmbushur detyrimet që burojnë nga ligji, duke nisur që nga angazhimi i tij për të mbledhur nënshkrimet mbështetëse ashtu edhe dorëzimin e dokumentacionit të plotë të kandidimit në KQZ përpara afatit maksimal të vendosur nga Kodi Zgjedhor. Me datë 29 Mars 2023, pesë ditë përpara afatit maksimal të vendosur nga Kodi Zgjedhor, Kosta Garo depozitoi në KQZ një kopje të dokumentacionin që pretendohet se mungonte.

- Përsa më sipër pala paditëse duke u bazuar në dispozitat procedurale dhe materiale kërkon:
- Ndryshimin e Vendimit Nr.10 datë 28.03.2023 të KZAZ-së Nr.82, dhe Vendimit Nr. 43 datë 03.04.2023 të Komisionit të Apelimeve dhe Sanksioneve (KAS).
- Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendos regjistrimin e subjektit Partisë Nisma Thurje dhe kandidatit Kosta Garo si kandidat për kryetar i bashkisë Dropull në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

10. Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit ka pretenduar se:

- Referuar pretendimit të parë të paditësit, se “në procesverbalin për dorëzimin e dokumenteve të kandidimit (model KQZ-00-31) nuk është shënuar asnjë vërejtje për mungesë dokumentacioni, për këtë arsye janë të pabazuara pretendimet e ngritura nga KZAZ-ja nr. 82 për mosdorëzim të dokumentacionit të plotë të kandidimit”, pala e paditur parashtron se:
Procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të kandidimit (Model KQZ-00-31) është dokumenti që pasqyron dorëzimin e dokumenteve të kandidimit, por nuk përmban të dhëna lidhur me shqyrtimin e rregullsisë së dokumenteve. Fakti nëse dokumentet e depozituara janë të rregullta apo kanë të meta, ose janë të paplota, shënohet në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së dhe për këtë procedurë janë të pranishëm përvec anëtarëve të KZAZ-së, edhe subjekti zgjedhor i interesuar. Në rastin konkret, në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 82, përkatësisht në shënimin e datës 27.03.2023, ora 00:20, shkruhet se “pasi u konstatuan mungesa në dokumentacionin dhe në mungesë të sekretarit me vulën përkatëse iu komunikua kandidatit, z. Kosta Garo të plotësojë sipas dispozitave të kodit zgjedhor kartat e identitetit ID (Fotokopje) me nënshkrimet e zgjedhësve brenda orës 18:00 për të plotësuar dokumentacionin datë 28.03.2023”, si dhe shënimi i datës 28.03.2023, ora 20:00, në të cilin, ndër të tjera, shkruhet se “Stafi i KZAZ priti deri në orën 20:55 dhe përsëri subjekti nuk paraqiti dokumentat ID dhe nënshkrimet. Për këtë arsye KZAZ mori vendim të mospranimit të kandidaturës së subjektit “Nisma Thurje” për kandidat për kryetar të bashkisë në zgjedhjet vendore 14 maj 2023 për arsye të mungesës së dokumentacionit”. Procesverbali është nënshkruar në çdo faqe nga të gjithë anëtarët në detyrë të KZAZ-së (katër anëtarë), por nuk është vulosur për shkak të mungesës së sekretarit të KZAZ-së.
- Procesverbali (model KQZ-00-31) nuk ka asnjë rubrikë ku të shënohet se është bërë dorëzimi i fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve që mbështesin kandidimin. Kjo do të thotë për ankuesin, se procesverbali model KQZ-00-31 nuk mund të përdoret prej tij si provë pozitive se ai ka bërë faktikisht dorëzimin fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve, sepse procesverbali nuk e përmban këtë informacion.
- Lidhur me pretendimin e dytë të paditësit, se “mbledhja e KZAZ-së nr. 82 për shqyrtimin e dokumenteve të depozituara nga subjekti zgjedhor nuk është zhvilluar në mënyrë publike dhe është zhvilluar pa praninë e kandidatit Kosta Garo”, pala e paditur prapësoi se nëse subjekti i interesuar i rri larg procedurave, nuk merr pjesë në mbledhje dhe nuk është proaktiv kur trupa shqyrton kërkesat e tij, atëherë pretendimet e tij për shkelje gjatë zbatimit të procedurave mund të merren veçse me rezervë.
- Në seancën e shqyrtimit, KAS-i thirri për të dëshmuar z. Arjan Gjini, i cili është monitorues i KQZ-së për zonën, njëkohësisht trainer i KQZ-së për administratën zgjedhore. Sipas dëshmisë së dhënë para KAS-it, z. Gjini ka monitoruar veprimtarinë e

KZAZ-së nr. 82 përgjatë procedurave të regjistrimit të datës 28.03.2023 dhe ka mundur të konstatojë personalisht mungesën e dokumentacionit shoqërues të formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (mungesën e letërnjoftimeve). Z. Gjini ishte informuar nga anëtarët e KZAZ-së, se ishin në pritje të subjektit zgjedhor “Nisma Thurje” për plotësimin e dokumentacionit, si dhe kishte asistuar teksa KZAZ-ja bënte veprimet e përshkuara në librin e protokollit për verifikimin e listës së zgjedhësve mbështetës të kandidatit. Dëshmia e z. Gjini konfirmon në mënyrë të besueshme shënimet e KZAZ-së në librin e protokollit. Vetë z. Gjini rezulton dëshmitar i besueshëm, sepse ai më datë 28.03.2023 ka bërë raportim në KQZ për gjetjet nga monitorimi në këtë KZAZ, duke komentuar për ankuesin se “u konstatua se dokumentat e kandidatit të “Nisma Thurje” kishin mangësi në përmbajtje”, konstatim që është depozituar në KQZ rreth orës 15:00 të datës 28.03.2023, kohë përpara se KZAZ-ja të merrte vendimin për mospranimin e dokumentave të kandidimit.

- Lidhur me pretendimin e tretë të paditësit, për afatin 24 orë të vendosur për plotësimin e dokumentacionit, afati maksimal që parashikon Kodi Zgjedhor për ridepozitim dhe dokumentacionit të korrigjuar, është 45 ditë para datës së zgjedhjeve, d.m.th. jo më vonë se data 30 mars 2023. Udhëzimi Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 nuk ka të përcaktuar si akordohet ky afat rast pas rasti. Çështja mbetet diskrecion i KZAZ-së, por nuk mund të jetë ushtrim arbitrariteti. Koha në dispozicion të subjektit për korrigjime dhe plotësime duhet të jetë racionalisht e mjaftueshme për kryerjen e tyre. Kjo do të thotë, se afati caktohet në bashkëpunim me palën e interesuar dhe me qëllimin e mirë që detyra e lënë të plotësohet saktësisht dhe me sukses. Afati i lënë prej 24 orësh në rastin konkret nuk mund të konsiderohet arbitrar nga ana e KAS-it, sepse me të nuk u lidh asnjë pretendim konkret në seancë.
- Lidhur me pretendimin e ankuesit që kundërshton pretendimin e KZAZ-së se disa prej zgjedhësve që kanë nënshkruar për të mbështetur kandidimin e kandidatit Kosta Garo nuk janë zgjedhës në bashkinë Dropull, pala e paditur prapëson se:
Në seancën e shqyrtimit pranë KAS, anëtarët e KZAZ-së u shprehën se verifikimi i të dhënave të zgjedhësve që kanë nënshkruar janë bërë nëpërmjet thirrjeve telefonike, nga ku rezultoi se një pjesë e zgjedhësve kishin numra telefoni të pasaktë, për një pjesë tjetër nuk korrespondonin identiteti i zgjedhësit me identitetin e mbajtësit të telefonit, për një pjesë të dhënave ishin të gabuara, sikurse kishte midis tyre që nuk ishin banorë të bashkisë Dropull. Rregullat e KQZ-së (udhëzimi i Komisionerit nr.1, datë 18.01.2023) nuk kanë përcaktuar procedurën konkrete të verifikimit, duke i lënë dorë të lirë KZAZ-ve që të bëjnë verifikimin si ta gjykojnë ato më të përshtatshme. Anëtarët e KZAZ-së shpjeguan në seancën e shqyrtimit se, për shkak të natyrës së zonës zgjedhore me numër të vogël zgjedhësish, ata i njihnin personalisht nënshkruesit dhe kishin bindjen se një numër i tyre nuk ishin banorë të zonës, ose jetonin familjarisht jashtë vendit dhe për këtë shkak kishte dyshime nëse ata ishin firmëtarët e listës së dorëzuar në datë 27.03.2023 si dhe fotove/fotokopjeve të kartave ID dhe pasaportave në një datë të mëvonshme.
- Për sa më sipër, kërkojmë pala e paditur kërkoj rrëzimin e kërkesëpadisë të paraqitur nga paditësi Partia Nisma Thurje.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 03.04.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 39, datë 29.03.2023, të depozituar nga Partia ‘Nisma Thurje’, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”.

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:

11. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesëpadisë të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidati për kryetar i Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, Kolegji Zgjedhor konstaton se partia “Nisma Thurje”, është regjistruar pranë KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023. Në vijim për procedurave për regjistrimin në zgjedhjet vendore, ky subjekt zgjedhor, në zbatim të nenin 67 pika 1 e Kodit Zgjedhor sipas të cilit: *“Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar bashkie të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë, regjistrohen në KZAZ-në që bulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë”*, i është drejtuar KZAZ nr.82, për të regjistruar z. Kosta Garo si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull.

12. Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Kodi Zgjedhor për regjistrimin e një kandidati, subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidati i saj z. Kosta Garo, kanë depozituar pranë KZAZ nr. 82, dokumentacionin përkatës për regjistrimin e kandidatit, sipas listës përkatëse të dokumentuar në procesverbalin model KQZ-00-31. Pjesë e listës së dokumentave të depozituara pranë KZAZ nr. 82, ka qënë edhe lista e nënshkruar nga 215 zgjedhës mbështetës së kandidatit Kosta Garo. Depozitimi i kësaj liste si pjesë e dokumentacionit për regjistrimin z. Kosta Garo, si kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Dropull, është bazuar në nenin 62 të Kodit Zgjedhor në të cilin parashikohet shprehimisht se: *“Kandidatët për organet e qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, ose në organet e qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1% e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 zgjedhës dhe jo më pak de 50 zgjedhës”*.

13. Referuar vendimeve të KZAZ nr. 82 dhe KAS të cilat janë objekt kundërshtimi pranë Kolegjit Zgjedhor, rezulton se këto të fundit kanë konkluduar se lista e zgjedhësve që kanë mbështetur kandidatin Kosta Garo i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, nuk ka qënë e plotë, pasi nuk është shoqëruar edhe me kopje të dokumentave të identifikimit të nënshkruesve, si dhe pasi është njoftuar për këtë të metë të dokumentacionit, kandidati nuk e ka plotësuar atë brenda afati të përcaktuar. Në këto kushte, KZAZ nr. 82, me vendimin Nr.10, datë 28.03.2023 ka refuzuar regjistrimin e z.Kosta Garo, si kandidat i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, për kryetar të Bashkisë Dropull.

14. Kolegji Zgjedhor, vlerëson se vendimi nr.10, datë 28.03.2023 i KZAZ nr. 82, sipas të cilit refuzimi i regjistrimit z.Kosta Garo, si kandidat i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” për kryetar të Bashkisë Dropull, për shkak se nuk ka depozituar fotokopjet e letërnjoftimeve të vlefshëm, të nënshkruar prej çdo zgjedhësi, nuk është i bazuar në ligj. Për rrjedhojë, edhe vendimi i KAS, që ka lënë në fuqi këtë vendim vlerësohet i pabazuar në ligj.

15. Bazuar në nenin 71 pika 2 e Kodit Zgjedhor, sipas të cilit: *“Zgjedhësit depozitojnë personalisht nënshkrimet e tyre në formularin tip. Formulari duhet të përmbajë identitetin e plotë të zgjedhësit, datëlindjen e tij dhe numrin telefonik të kontaktit. **Bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe fotokopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës.** Në zbatim të nenit 69 të këtij Kodi, zgjedhësi duhet të jetë i regjistruar*

në zonën zgjedhore përkatëse”, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kopja e letërnjoftimeve të nënshkruesve i bashkëlidhet formularit tip dhe është pjesë e tij për efekt të ligjit, duke u konsideruar një dokument i vetëm.

16. Në rastin konkret, rezulton se z. Kosta Garo ka depozituar pranë KZAZ nr. 82 listën e dokumentave të nevojshme për regjistrim, pjesë e së cilave ka qënë edhe formulari tip, i nënshkruar nga 215 zgjedhës. Ky fakt vërtetohet nga procesverbali model KQZ-00-31 i administruar në cilësinë e provës. Në këtë procesverbal të nënshkruar nga z. Kosta Garo në cilësinë e dorëzuesit të dokumentacionit dhe nga kryetari i KZAZ nr. 82, z. Gligor Dushi, në cilësinë e marrësit në dorëzim të dokumentacionit, rezulton se me nr. rendor 1, është pasqyruar dorëzimi i dokumentit *“Formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ-04-01”*. Në këtë procesverbal, pavarësisht ekzistencës së rubrikës *“vërejtje”* në krahasim të çdo dokumenti që përmban lista, nuk rezulton të jetë pasqyruar ndonjë shënim, sa i takon mungesës së dokumentave të identifikimit të nënshkruesve në formularin për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve. Sa kohë që në këtë procesverbal model (KQZ-00-31), nuk ka asnjë rubrikë të veçantë për të pasqyruar si dokument më vete fotokopjet e dokumentave të identifikimit të nënshkruesve të formularit tip (KQZ-04-01), konkludohet se ashtu sikurse e parashikon ligji (neni 71 i Kodit Zgjedhor), ato konsiderohen pjesë përbërëse e formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje të kandidatit dhe administrohen si një dokument i vetëm.

17. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se procesverbali model KQZ-00-31, përbën një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese bazuar në nenin 253 të K.Pr.Civile. Në këto kushte, sa kohë që nuk është bërë asnjë vërejtje nga nënshkruesi përfaqësues i KZAZ Nr. 82, rezulton se provon faktin se formulari tip KQZ-00-01, është paraqitur i plotë sikurse e parashikon Kodi Zgjedhor në nenin 71 pika 2 e tij.

18. Pavarësisht sa më sipër, edhe nëse do të prezumohej se kandidati Kosta Garo nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin, sikurse është pasqyruar në librin e protokollit të mbajtur nga anëtarët e KZAZ nr. 82, Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk përmbushen kushtet ligjore për refuzimin e regjistrimit të z. Kosta Garo si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull, paraqitur nga subjekti zgjedhor *“Nisma Thurje”*. Sikurse rezulton nga provat e paraqitura nga KQZ, më datë 27.03.2023 në orën 00.20, KZAZ Nr. 82 ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, i paraqitur nga subjekti zgjedhor *“Nisma Thurje”* dhe ka konstatuar se ky i fundit nuk kishte depozituar kopje të ID me nënshkrimet e zgjedhësve që kanë nënshkruar formularin për mbështetjen e kandidatit. Referuar shënimit të bërë në librin e protokollit, rezulton se i është komunikuar kandidatit që të plotësojë dokumentacionin sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor duke i caktuar afat deri më datë 28.03.2023 ora 18.00.

19. Përveçse shënimit si më sipër të bërë në protokollin e mbledhjeve të miratuar nga KQZ sipas formularit KQZ-02-01, nuk rezulton asnjë e dhënë në lidhje me mënyrën e njoftimit të kandidatit

Kosta Garo për plotësimin e dokumentacionit apo konfirmimin e dijenisë së tij në lidhje me këtë fakt. Kolegji Zgjedhor vlerëson se penalizimi i një subjekti zgjedhor për mosveprimin e tij, nuk mund të ketë efekt në rastet e mungesës së dijenisë. Nga ana tjetër, Kolegji e gjen të pabazuar edhe argumentin e përdorur nga KAS në vendimin e tij, sipas të cilit nëse subjekti i interesuar rri larg procedurave, nuk merr pjesë në mbledhje dhe nuk është proaktiv kur trupa shqyrton kërkesat e tij, atëherë pretendimet e tij për shkelje të zbatimit të procedurave mund të merren veçse me rezervë. Në rastin konkret, rezulton se mbledhja e KZAZ nr. 82, është mbajtur në mesnatën së datës 27.03.2023 dhe për rrjedhojë, mosprezenca e subjektit të interesuar në atë orë, nuk mund të interpretohet si neglizhencë apo mungesë interesi për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur. Nga ana tjetër, mosprezenca e kandidatit në mbledhje, nuk përbën shkak ligjor që ia të mos njoftohet për plotësimin e të metave të dokumentacionit të konstatuara. Nga shënimet e bëra në librin e protokollit, nuk rezulton asnjë e dhënë minimalisht në lidhje me mënyrën e njoftimit të z. Kosta Garo, element ky i rëndësishëm, për të vlerësuar nëse realisht ekziston sjellja neglizhente, pasojë e së cilës ka qënë edhe vendimarrja e KZAZ nr. 82 për mosregjistrimin e tij si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull.

20. Nga aktet e administruara rezulton i provuar fakti se kandidati z. Kosta Garo, pasi është vënë në dijeni të vendimit nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 82, për refuzimin e regjistrimit të tij si kandidat i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, për kryetar bashkie në Bashkinë Dropull, më datë 29.03.2021, së bashku me subjektin zgjedhor “Nisma Thurje” ka paraqitur kërkesë ankimore kundër vendimit të KZAZ në KQZ. Së bashku me kërkesën ankimore dhe dokumentacionin tjetër të kandidimit, ankuesi ka depozituar edhe fotokopje të nënshkruara të letërnjoftimeve të 215 zgjedhësve që kanë nënshkruar listën mbështetëse për kandidatin. Depozitimi i këtij dokumentacioni një ditë pas vendimit të KZAZ nr.82, konfirmon faktin e disponimit të tij nga kandidati së bashku me listën e zgjedhësve mbështetës. Në këto kushte, edhe nëse ky dokumentacion nuk do të ishte depozituar prej tij në datën e paraqitjes së kërkesës për regjistrim, nuk kishte arsye të mos ishte paraqitur pas njoftimit nga KZAZ nr. 82 për plotësimin e dokumentacionit, nëse ky njoftim do të ishte kryer në mënyrë efektive.

21. Përveç sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se depozitimi i dokumentacionit plotësues (fotokopje e dokumentave të identifikimit të listës së zgjedhësve mbështetës), së bashku me kërkesën ankimore ndaj vendimit Nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 82, rezulton të jetë bërë brenda afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Konkretisht, në nenin 73 pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor parashikohet shprehimisht se: *“1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim **jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve.** 2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet **jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve.** Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre”.*

22. Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se edhe nëse do të prezumohej se z. Kosta Garo nuk ka depozituar kopje të dokumentave të identifikimit të

nënshkruar nga zgjedhësit mbështetës që kanë nënshkruar formularin tip të miratuar nga KQZ në momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrim, në mungesë të provave për njoftimin e kandidatit z. Kosta Garo për të plotësuar dokumentacionin si dhe mundësisë reale të tij për të plotësuar këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar nga KZAZ nr. 82, do të konsiderohet se ai e ka plotësuar dokumentacionin më datë 29.03.2021. Kjo datë e plotësimit të dokumentacionit korespondon me ditën e 46 para datës së zgjedhjes, duke u konsideruar se është respektuar afati i prashikuar nga Kodi Zgjedhor.

23. Nga ana tjetër, në lidhje me procedurën e verifikimit të nënshkrimeve të zgjedhësve mbështetës, të ndjekur nga anëtarët e KZAZ Nr. 82, referuar shënimeve të bëra në librin e protokollit, Kolegji Zgjedhor vlerëson se kjo procedurë nuk afekton regjistrimin e z. Kosta Garo si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”. Në arritjen e këtij përfundimi, Kolegji Zgjedhor mban në konsideratë faktin se kjo procedurë nuk është kryer në zbatim të neni 71 pika 3 e Kodit Zgjedhor, në të cilin parashikohet shprehimisht se: *“Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi”*.

24. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, Kolegji Zgjedhor vlerëson se objekt i verifikimit nga KZAZ, duhet të jetë cilësia e zgjedhësve nënshkrues, si banues në zonën zgjedhore. Një verifikim i tillë nuk rezulton të jetë kryer nga KZAZ, fakt i cili është konfirmuar edhe në vendimin Nr. 43, datë 03.04.2023 të KAS, i cili nuk e ka konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të zgjedhësve. Nga ana tjetër, pala paditëse ka provuar cilësinë e zgjedhësve të verifikuar, si banorë në Zonën Zgjedhore Dropull, duke paraqitur në cilësinë e provës kërkimin e bërë nëpërmjet sistemit e-Albania, për cilësinë e tyre në listën e zgjedhësve për Bashkinë Dropull. Pamundësia apo dështimi i KZAZ nr. 82 për të verifikuar listën e zgjedhësve mbështetës të kandidatit për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, nuk mund të përbëjë element penalizues për këtë të fundit në regjistrimin e tij në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023.

25. Pavarësisht analizës së mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se shkak ligjor mbi të cilin KZAZ nr. 82, ka marrë vendimin Nr. 10, datë 28.03.2023 (objekt kundërshtimi nga pala paditëse), është fakti se kandidati për kryetar të Bashkisë Dropull i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, z. Kosta Garo, nuk ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim brenda afatit të përcaktuar nga KZAZ. Në vendimin e saj KZAZ nr. 82, nuk ka konsideruar shkak për refuzimin e regjistrimit mungesën e numrit minimal të zgjedhësve mbështetës, pavarësisht verifikimit të bërë në kundërshtim me parashikimin e nenit 71 të Kodit Zgjedhor.

26. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor vlerëson se refuzimi i regjistrimit të z. Kosta Garo si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull, bazuar në argumentin se ai nuk ka plotësuar brenda afatit dokumentacionin e plotë për regjistrim, nuk është i bazuar në ligj. Në interpretim të dispozitave të Kodit Zgjedhor si dhe provave të paraqitura nga KQZ mbi bazën e të cilave është dokumentuar procedura administrative e ndjekur nga KZAZ nr. 82 për trajtimin e kërkesës z. Kosta Garo për regjistrimin e tij si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, rezulton se kandidati Kosta Garo ka plotësuar dokumentacionin brenda afatit ligjor dhe për rrjedhojë, ai duhet të regjistrohet në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

27. Kolegji Zgjedhor vlerëson se mosregjistrimi i z. Kosta Garo si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, në kushtet e plotësimit të dokumentacionit sikurse është analizuar në këtë vendim, përbën cënim të parimit të kushtetues të pluralizimit dhe të drejtës për t’u zgjedhur. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 3 të saj ka parashikuar se pluralizmi përbën një nga bazat e shtetit të së drejtës, e cila duhet të mbrohet dhe të respektohet, ndërsa neni 1, paragrafi 3 i saj sanksionon *parimin e barazisë së votes*. Gjithashtu në nenin 45 pika 1 e Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet”*.

28. Parimi i pluralizimit politik, për vetë rëndësinë që ka në një shtet të së drejtës, është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 32, datë 21.06.2010 është shprehur se: *“...pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme... Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për të bërë këtë”*.

29. Kolegji Zgjedhor, vlerëson se në rastin konkret, interpretimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor që disjolin afatet e plotësimit të dokumentacionit nga kandidatët, duhet të bëhet në mënyrë pajtuese me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe parimet që qëndrojnë në themel të saj. Sikurse është arsyetuar në këtë vendim gjyqësor, rezulton se kandidati për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, i paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, ka paraqitur dokumentacionin e plotë për regjistrim në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, brenda afatit

të parashikuar nga neni 73 pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe për rrjedhojë, ai duhet të regjistrohet në këto zgjedhje.

Si përfundim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se vendimi Nr. 10, datë 28.03.2023 i KZAZ nr. 82 si dhe vendimi Nr. 43, datë 03.04.2023 i KAS, nuk janë të bazuara në ligj. Për rrjedhojë, padia e paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidati për kryetar i Bashkisë Dropull z. Kosta Garo, duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Pranimin e padisë.
2. Shfuqizimin e vendimit Nr. 43, datë 03.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe vendimit Nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ Nr.82.
3. Detyrimin e KQZ/KZAZ Nr. 82, të regjistroje si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull z. Kosta Garo, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, në datë 13.04.2023.

GJYQTARE GJYQTARE GJYQTARE GJYQTARE GJYQTARE
Alma KOLGJOKA Emona MUÇI Blerona HASA Esmeralda XHILI Marsela DERVISHI